



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E FINANCAVE

Nr. 17888 prot.

Tiranë, më 17.12.2025

UDHËZIM

Nr. 26, datë 17.12.2025

**“PËR  
DISA SHTESA DHE NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 3, DATË 23.1.2018,  
“PËR VLERËSIMIN E MALLRAVE PËR QËLLIME DOGANORE”**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në zbatim të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar dhe bazuar në pikat 4 dhe 5, të nenit 161, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 651, datë 10.11.2017, “Për dispozitat zbatuese të ligjit nr. 102/2014, “Kodi Doganor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me qëllim lehtësimin dhe zbatimin praktik nga administrata doganore të procedurës dhe metodologjisë së vlerësimit të mallrave për qëllime doganore, ministri i Financave,

**UDHËZON:**

Në udhëzimin nr. 3, datë 23.1.2018 “Për vlerësimin e mallrave për qëllime doganore”, të ministrit përgjegjës për financat, bëhen shtesat dhe ndryshimet si më poshtë:

1. Në nënpikën 15.1, të pikës 15, bëhen ndryshimet si më poshtë:

- Në shkronjën “a”, togfjalëshi “*Thomson-Reuters*” zëvendësohet me fjalën “*Refinitiv*”;
- Në shkronjën “b”, fjala “*Platts*” zëvendësohet me togfjalëshin “*S&P Global Commodity Insights*”;
- Në shkronjën “c”, togfjalëshi “, si “*Metal Bulletin*”, “*Steel Week*”” zëvendësohet me togfjalëshin “dhe lingotave të bakrit, aluminit dhe zinkut të marra nga agjencia kombëtare “*Fast Market*” dhe “*London Metal Exchange (LME)*”;

c) Shkronja "f", ndryshon si më poshtë:

*"Buletine të çmimeve të automjeteve si: "Quattroruote", "Schwackeliste" dhe site si "cars.com", "impact auto", "auto win", "dubizzle", "mobile.de", "dueruote";".*

d) Shkronja "g" e parë hiqet.

2. Në nënpikën 15.2, të pikës 15, bëhen ndryshimet si më poshtë:

a) Togfjalëshi "dhe miratohen nga Komisioni Ad-Hoc në varësi të ministrit të Financave", hiqet;

b) Pas fjalisë së parë, shtohet fjalia me përmbajtje si më poshtë:

*"Drejtoria e Vlerësimit në Qendër i referon komisionit të posaçëm të ngritur për këtë qëllim nga Drejtori i Përgjithshëm i Doganave, të shqyrtojë propozimet rast pas rasti dhe vetëm pas miratimit nga ky komision reflektohen ndryshimet në "Dosjen e të Dhënave të Disponueshme".*

3. Nënpara 15.3, e pikës 15, ndryshon si më poshtë:

*"Për artikujt që sigurohen informacione nga burimet e përmendura në nënpikën 15.1, shkronjat "a", "b", "c", "d" dhe "f", vendosja dhe rishikimi i çmimeve në "Dosjen e të Dhënave të Disponueshme", bëhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, pa kaluar në komisionin e posaçëm për këtë qëllim."*

4. Nënpara 16.1, e pikës 16, ndryshon si më poshtë:

*"16.1/a) Për artikujt e karburanteve të tilla si: benzinë, gazoil, vajgur, jet, lëndë djegëse me përmbajtje sulfuri, gaz i lëngshëm (butan, propan), biodizel (dhe të gjitha nënproduktet), naftë bruto, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Përditësimi i këtyre artikujve bëhet çdo ditë pune;*

*16.1/b) Për artikujt lingota bakri, alumini dhe zinku, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Përditësimi i këtyre artikujve bëhet çdo ditë pune."*

5. Nënpara 16.2, e pikës 16, ndryshon si më poshtë:

*"Për artikujt grurë, misër, krunde, oriz, sheqer, vaj ushqimor, kafe, bërsi, elb, tërshërë, produktet e çelikut, hekurit, skrap, llamarina, profile dhe produkte të tjera prej çeliku etj, plehrat kimike, lëndë e parë plastike dhe bitum, Drejtoria e Vlerësimit në Qendër harton shkresën me çmimet e përditësuara dhe pas miratimit nga titullari i institucionit ua dërgon degëve doganore dhe strukturave të tjera që ju nevojitet ky informacion. Afati i përditësimit bëhet çdo 2 javë (fillim dhe mes muaji)."*

6. Nënpara 16.3, e pikës 16, hiqet.

7. Nënpara 17.1, e pikës 17, ndryshon si më poshtë:

*“17.1 Për zhdoganimin e automjeteve, në rastet kur nuk pranohet transaksioni dhe nuk është i mundur përdorimi i metodave të tjera, vlerësimi bazohet në buletinet dhe site-t e cituara në pikën 15/1/f, në të cilat pasqyrohen çmimet e shitjes në tregjet evropiane.”.*

8. Nënpara 17.4, e pikës 17, ndryshon si më poshtë:

*“17.4 Vlera për kamionçina, furgona dhe kamionë që gjendet në buletinet dhe site-t e cituara në pikën 15/1/f, nisur nga marka, modeli dhe viti i prodhimit nuk duhet të jetë më e ulët se 80% e çmimit të gjendur në tabelë.”.*

9. Në pikën 17, shtohet nënpara 17.5 me përmbajtje si më poshtë:

*“17.5 Vlerësimi i automjeteve me vit prodhimi para vitit të fundit të publikuar në këto buletine dhe site nuk mund të llogaritet më pak se çmimet e pasqyruara si më poshtë vijon:*

*Për autoveturat çmimet janë:*

- a) Deri 1400 cc jo më pak se 162 500 lekë*
- b) Mbi 1400-1900 cc jo më pak se 250 000 lekë*
- c) Mbi 1900-2500 cc jo më pak se 406 000 lekë*
- d) Mbi 2500-3000 cc jo më pak se 500 000 lekë*
- e) Mbi 3000-4500 cc jo më pak se 625 000 lekë*
- f) Mbi 4500 cc jo më pak se 1 000 000 lekë*

*Për kamionçina, furgona dhe kamionë, sipas kapacitetit mbajtës çmimet janë:*

- a) Deri në 1.5 tonë jo më pak se 500 000 lekë*
- b) Nga 1.5 tonë deri në 3.5 tonë jo më pak se 750 000 lekë*
- c) Nga 3.5 tonë deri në 10 tonë jo më pak se 1 062 500 lekë*
- d) Nga 10 tonë deri në 15 tonë jo më pak se 1 250 000 lekë*
- e) Mbi 15 tonë jo më pak se 1 500 000 lekë.*

9. Pika 18, hiqet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në “Fletoren Zyrtare”.

**MINISTRI**

**Petrit Malaj**

Adresa: Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 3, 1001, Tiranë, <https://www.financa.gov.al>